

Të ndëruar Zonja dhe Zotërinj,

- “Kundërshtimi i korrupsionit në qeveri është një tipar i lartë i patriotizmit” - Edvard Grifin
- Për arsye se: Korrupsioni është keqpërdorim i fuqisë së dhënë – i lëndon njerëzit e zakonshëm çdo ditë(transparencyinternational.org)
- Korrupsioni asnjëherë nuk duhet të kuptohet si fakt i paracaktuar që duhet të pranohet
- Korrupsioni është një virus i cili përhapet nëse nuk trajtohet menjëherë dhe në mënyrë efektive
- Korrupsioni nuk shkakton dëme vetëm në shtet dhe në ekonomi-i dëmton njerëzit: i deprivon qytetarëve nga gjërat që i takon atyre: arsim adekuat dhe cilësor, shëndëtsi adekuat dhe cilësore, sigurimin dhe mbrojtjen.
- Korrupsioni është edhe vazdon të jetë një nga sfidat më të mëdha me të cilat ballafaqohen të gjithë qeveritë. Në kohën e krizave ekonomike, ky problem bëhet edhe më i rëndësishëm.

Për të fituar virusin na duhet: ndryshime në mentalitet dhe në sjellje. Na nevojitet një qasje shumëanëshme: nuk është e mjaftueshme të përballojmë vetëm në një sektor: të gjitha duhet të inkuadrohen

Pikërisht kjo është qëllimi themelor i ekzistencës së ALAK qendrave: për t'u ndihmuar qytetarëve të inkuadrohet në këtë proces.

Si?

- Nëpërmjet sigurimit të informatave, ndihmë dhe këshilla, përmes analizës së ankesave dhe kapacitetin e qeverisë të përballet me ata, përmes rritjes së ndërgjegjshmërisë dhe nevojës për integritet dhe transparencë, duke siguruar mbështetjen e qeverisë në rritjen e nivelit të integritetit dhe transparencës.
- Është e nevojshme më shumë sesa miratimi i ligjeve të reja ose krijimi i institucioneve të reja për të përballur problemin e korrupsionit. Në Maqedoni nuk mungojnë ligjet ose institucione të reja. Këtu bëhet fjalë për një çështje për zbatimin, ekzekutimin dhe koordinimin e aktiviteteve të cilat ndërmarren kundër korrupsionit.
- Edhe më e rëndësishme, bëhet fjalë për ndryshimet në vetëdije dhe për inkuadrimit të qytetarëve, sepse në fund ata paguajnë për llogarinë nga ato ndhodhi. Ata duhet të inkurajohen dhe të mbrohen me qëllim që të inkuadrohen.
- Holanda ka një përkushtim të madhë në promovimin e inkuadrimit të qytetarëve në luftën kundër korrupsionit dhe në përkrahjen e qeverisë së mirë. Qytetarët të cilat janë të inkuadruar, të fortë dhe janë të informuar me elementin kyq në secilën shtet demokratik në të cilën ekziston sundimi i së drejtës. Vetëm nëse qytetarët janë aktivisht të inkuadruar, demokracia do të jetë reale me tërë kuptimin e fjalës së vërtet.
- Kjo është arsyeja kryesore pse Holanda vendosi të përkrah këtë projekt: të konsolidohet dhe të rritet ndikimi i ALAK –ut që e kishte deri tani, por edhe të

sigurohet qëndrueshmëria e saj. Koncepti i ALAKu nuk është i ri në këtë shtet. ALAK Qendra në Shkup ka qenë një nga të parat të cilat ishin formuar që nga viti 2003. Modeli i ALAK-ut për momentin është një nga eksperimentet më dinamike në intervenimet kundër korrupsionit të cilat zbatohen nga lëvizja globale e Transparency International. Sot ekzistojnë Qendra ALAK në më shumë se 50 shtete, dhe më shumë se 120.000 persona të cilat kanë kontaktuar me një nga ato qendrat.

- Me hapjen e të dy zyrave të reja të ALAK-ut në Tetovë dhe Shtip, Transparency International-Maqedoni sjell këtë koncept më afër qytetarët. Kjo zyrë e ALAK-ut në Tetovë duhet ti ndihmon qytetarëve të këtij rajoni për të rritur efikasitetin në luftën kundër korrupsionit. Përmes kontaktit direkt me qytetarët zyra do të mundëson kuptimin e më të thellëshëm për funksionimin e korrupsionit në praktikë.
- Na duhet një qasje e shumëanshme nëse kemi dëshirë të lirohemi nga virusi i korrupsionit. Ky proces nuk mundet të udhëhiqet vetëm nga një sektor, aq më pak nga Qeveria dhe agjencionet e saja. Procesi duhet të jetë i bashkëngjitur me ndryshimet në sjelljen dhe vetëdijën në të gjitha palet e inkuadruar, qeveria, sektori privat dhe qytetarët. Siq përmenda, inkuadrimi i qytetarëve është me rëndësi shumë të madhe për qëndrueshmërinë e suksesit të këtyre aktiviteteve.
- Unë do të doja të ju uroj një fillim të suksesshëm të punës dhe në të njëjtën kohë do të doja të inkurajojmë që ta përdorni këtë mundësi për të kontribuar në funksionimin e një sistemi të vërtetë demokratik në këtë vend!